



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtora i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	03.04.2025
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Mars

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.03.2025 deri me 31.03.2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit mars, kemi vazhduar me aktivitetet e planifikuara në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Puna jonë ka përfshirë monitorimin, implementimin dhe përgatitjet për projektet në vazhdim, duke u fokusuar në përmirësimin e kushteve për fermerët dhe përfituesit.

Gjatë kësaj periudhe, kemi vazhduar me monitorimin e serave me një sipërfaqe prej rreth 100 m². Procesi i montimit të folisë nga operatori ekonomik është duke vazhduar dhe besojmë se për këtë fillim pranvere serat do të jenë të gatshme për përfituesit, duke i mundësuar atyre të fillojnë me mbjelljet e tyre në kohën e duhur.

Kemi nisur procedurat e prokurimit për mekanizëm bujqësor të llojit motokultivator për përfituesit e listës pritëse. Sipas planifikimeve, gjatë muajve në vijim këto pajisje do të shpërndahen tek përfituesit, duke ndihmuar në përmirësimin e kushteve të punës në bujqësi.

Gjatë muajit mars kemi bërë thirrjen publike për subvencionimin e qumështit për litër. Ky subvencion synon të mbështesë fermerët që merren me blegtorinë dhe të rrisë prodhimin e qumështit në nivel të lartë.

Në bashkëpunim me organizatën QATAR Charity, kemi vazhduar me hapjen e puseve për familjet në nevojë. Ky bashkëpunim po zhvillohet sipas planifikimeve të parashikuara, duke ndihmuar familjet që kanë nevojë për burime të qëndrueshme ujore.

Gjithashtu, kemi kryer vizita në terren në dy projekte me organizatën IADK, për të parë nga afër fermerët që kanë aplikuar për grante. Këto vizita janë të rëndësishme për vlerësimin e nevojave dhe për të siguruar që ndihma të shkojë tek ata që kanë më shumë nevojë.

Kemi përfunduar të gjitha përgatitjet për subvencionet dhe pagesat direkte që do të hapen nga Ministria e Bujqësisë. Këto pagesa synojnë të mbështesin fermerët në zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarive të tyre bujqësore.

Kemi filluar me zhavorrimin e rrugëve fushore, sipas planifikimeve të bëra më herët. Këto ndërhyrje kanë për qëllim lehtësimin e qasjes në zonat bujqësore dhe përmirësimin e infrastrukturës për fermerët.

Gjatë muajit mars, kemi pranuar kërkesa të ndryshme nga fermerët për ndihmë dhe asistencë teknike. Komisioni përkatës ka dalë në terren për të vlerësuar këto kërkesa dhe për të ofruar zgjidhje të përshtatshme për secilin rast.

Muaji mars ka qenë një periudhë e angazhuar me aktivitete të ndryshme, të cilat kanë ndihmuar në përmirësimin e kushteve për komunitetin bujqësor. Me përfundimin e këtyre fazave, synojmë të vazhdojmë me implementimin e projekteve të tjera dhe të rrisim dinamikën e punëve në teren.